



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 369 2025

Në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale numër Nr. 03/L-40 neni 43, nenit 31 të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, bëjë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e tetë -VIII- të rregullt për vitin 2025 të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet me datë 21.08.2025 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2025.
3. Miratimi i Planit Zhvillimorë Komunal.
4. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2024-2025.
5. Informatë për korrije shirjet.
6. Të ndryshme.

Bashkë me ftesën ju dërgojmë:-

- Procesverbalin nga mbledhja e kaluar.
- Materialin e raportit të punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2025.
- Materialin e Planit Zhvillimorë Komunal.
- Materialin e informatës mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2024-2025 .
- Materialin e informatës për korrije shirjet.

Hani i Elezit
Data:-13.08.2025

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 6381 /2025
Data: 13.08.2025

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e shtatë -VII- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 31.07.2025 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetarë i Komunës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2025.
3. Raporti i auditorit të përgjithshëm për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2024.
4. Plani i Veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2024.
5. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025.
6. Raportin financiar për periudhën Janar – Qershor 2025 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
7. Informatë për sektorin e emergjencave.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me NR. 08/L-332 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 është në lartësi prej 3,615,457.00 €. Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim: Paga dhe shtesa 2,188,542.00 €, Mallra dhe shërbime 584,500.00 €, Shpenzimet komunale 94,000.00 €, Subvencione dhe transfere 143,000.00 €, Shpenzime kapitale 605,415.00 €, Totali i buxhetit është në shumë 3,615,457.00 €. Ndërsa buxheti përfundimtar siç mund ta shohim në tabelën më lartë është 4,073,012.65 €, ku në këtë shumë përfshihen:

1. Mjetet e ndara nga Grantet Qeveritare në shumë prej 3,275,738.00 €,
2. Projektioni i Të Hyrave Vetanake në shumë prej 339,719.00 €,
3. Bartja e bilancit të pashpenzuar nga viti 2024, në shumë prej 170,771.67 €,
4. Mjetet e mbetura nga Donacioni i Qeverisë Japoneze për projektin “Ndërtimi aneksit për këmbësor në urën e Seçishtës” në shumë prej 15,923.01 €,
5. Donacioni nga Unioni Evropian për projektin dy vjeçar “A smart system for Early Floods Detection and Easte Monitoring in the Lepenc River Basin” në shumë prej 176,135.45 €,
6. Shtesë në kategorinë buxhetore Paga dhe Shtesa, në shumë prej 94,611.84 €,
7. Mjete të mbetura nga Grante të cilat janë bartur vit pas viti në vlerë prej 113.68 €.

Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar - qershor 2025 është në shumë prej 1,758,538.44 €. Gjatë periudhës Janar-Qershor 2025, komuna Hani i Elezit ka realizuar të hyra vetanake direkte në shumë prej 1,073,084.60 €, që përfaqëson një rritje të konsiderueshme prej 561.06 % apo rritje në shumëfish prej 6.61 herë më shumë, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraparak 2024, kur është inkasuar vetëm 162,316.72 €. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Paga dhe Shtesa për periudhën Janar-Qershor të vitit 2025 është në shumë prej 1,126,876.70 € apo 99.69% nga Buxheti i alokuar dhe 51.49% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me vitin 2024 shpenzimi për këtë kategori përgjatë periudhës raportuese të vitit 2025 është më i lartë për 7,012.52 € apo 0.63 % më shumë. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Mallra dhe Shërbime për periudhën Janar-Qershor të vitit 2025 është në shumë 305,061.31 € apo 45.57% nga Buxheti i alokuar dhe 52.19% nga Buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024 shpenzimi për këtë kategori përgjatë tremujorit të vitit 2025 është më i lartë për 80,115.17 € apo 35.62 % më shumë. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Shpenzime Komunale për periudhën Janar-Qershor të vitit 2025 është në shumë prej 46,486.86 € apo 49.45% nga Buxheti i alokuar dhe 49.45% nga Buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024 shpenzimi për këtë kategori përgjatë vitit 2025 është më i lartë për 7,458.31 € apo 19.11 % më shumë. Shpenzimi i kategorisë buxhetore Subvencione dhe Transfere për periudhën Janar-Qershor të vitit 2025 është në shumë prej 106,474.68 € apo 71.94 % nga Buxheti i alokuar dhe 74.46 % nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024 shpenzimi për këtë kategori përgjatë vitit 2025 është më i lartë për 32,053.68 € apo 43.07 % më shumë. Nga kategoria buxhetore Shpenzime Kapitale, për periudhën Janar-Qershor të vitit 2025 është në shumë prej 173,638.89 € apo 19.77% nga buxheti i alokuar dhe 28.68% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori buxhetore. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024 shpenzimi për këtë kategori përgjatë vitit 2025 është më i lartë për 97,577.59 € apo 128.29 % më shumë. Shpenzueshmëria totale e Buxhetit të alokuar për periudhën raportuese Janar-Qershor 2025, duke i përfshirë të gjithë kategoritë buxhetore është në shumë prej 1,758,538.44 € apo 60.2%. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraparak 2024, shpenzimi total është 1,534,321.17 € apo 224,217.27 € më pak se në gjashtë mujorin e parë të vitit 2025.

Resul Suma thekson:- e lexova raportin dhe të hyrat në këtë vit ishin rekord por kërkoj informacion sa i përket dallimit të hyrave në këtë vit me vitin e kaluar.

Lindita Ballazhi thekson:-kemi tejkalim të konsiderueshëm të të hyrave vetanake veçanërisht në programin buxhetorë Urbanizmi dhe Kadastrë dhe kjo ka ndodhur për shkak të pagesës së një vendimi gjygjësor nga Ministria e Planifikimit Hapësinorë që ka të bëjë me shpronësimin e një parcele.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

3. Raporti i auditorit të përgjithshëm për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- raporti i auditimit ka rezultuar me pesë të gjetura apo rekomandime, një prej tyre është rekomandim i ri ndërsa katër të tjera janë të përsëritura. Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzime tjera shtesë për pagesat e ekzekutuara nga thesari. Këtë të gjetur ne e kemi kundërshtuar pasi që lëndët përbarimore që vijnë nga kontrata kolektive janë ekzekutuar drejtë për drejt nga thesari, kjo ka dal si e gjetur edhe pse nuk jemi përgjegjës për shkak se thesari nuk na ka njoftuar, as nuk ka kërkuar mendimin tonë për linjat buxhetore se ku do të ekzekutohen këto mjete. Rekomandimi i dytë ka të bëjë me keq klasifikimi i shpenzimeve por edhe kjo e gjetur ka të bëjë me lëndët përbarimore shpenzime këto që për nga natyra i tejkalojnë pagave dhe mëditjeve janë bërë nga kategoria e investimeve kapitale por edhe këtë të gjetur e kemi kundërshtuar pasi që ne nuk e kemi orientuar thesarin se ku do ti ekzekutojë mjetet por ata automatikisht në mënyrë të pavarur i kanë ekzekutuar nga linjat buxhetore ku ka pasur mjete. Rekomandimi i tretë ka të bëjë me nënvlerësimi i regjistrimit të pasurisë në Pasqyrat vjetore financiare. Rekomandimi i katërt ka të bëjë me çështjen e llogarive të arkëtueshme është rekomandimi i përsëritur. Rekomandimi i pestë ka të bëjë me mos themelimi i njësisë së auditimit të brendshëm nuk është që e kemi kundërshtuar por e kemi dhënë komentimin tonë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

4. Plani i Veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2024.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- për rekomandimin e parë planifikohen këto veprime që të ndërmerren, do të shtohet kontrolli në ekzekutimin e pagesave në afatin e parapri Ligjorë përveç lëndëve nga kontrata kolektive të cilat i ekzekuton thesari pa paralajmërim. Për rekomandimin e dytë do të ndërmerren këto veprime, në rastet prej të cilat ka rezultuar kjo e gjetur si OB nuk kemi përgjegjësi se mjetet janë ekzekutuar drejtpërdrejtë nga thesari pa paralajmërim. Megjithatë, për obligimet tjera të cilat krijohen do të shtohet kontrolli që këto obligime të ekzekutohen në përputhje me planifikimet buxhetore dhe kodet ekonomike përkatëse. Për rekomandimin e tretë do të shtohet kontrolli i regjistrimit të pasurisë. Për inkasimin e katërt do të shtohet kontrolli në inkasimin e të hyrave. Për rekomandimin e pestë i cili është dhënë do ti ri përsërisim kërkesat tona si OB për aprovimin e numrit të stafit sepse momentalisht nuk kemi pozita të lira në administratë komunale.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

5. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson:- Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive në komunën e Hanit të Elezit për gjashtë mujorin e vitit 2025 ka mbajtur tri (3) mbledhje të rregullta. Në takimet e rregullta të Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive zakonisht marrin pjesë:

Komandanti i stacionit policor, përfaqësuesi i policia kufitare vija e gjelbërt, përfaqësuesi i këshillit të bashkësisë islame, Kryesuesi i komitetit për komunitete, përfaqësuesi për barazi gjinore, drejtori i drejtorisë për arsim, përfaqësuesi i këshillit të prindërve, përfaqësuesi i FSK-së, drejtori i drejtorisë për shërbimeve publike dhe emergjencë, përfaqësuesi i KVRL-së. Përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Malik Berisha thekson:- çka është diskutuar konkretisht për rrugën Hani i Elezit - Gorancë sepse atje kemi frekuentim të veturave dhe nuk e shohë që dalin ndonjë herë policia dhe është mirë që me dal ndonjë herë në mënyrë që me pasur siguri më shumë.

Sevdi Dernjani thekson:- sa i përket rrugës Hani i Elezit – Gorancë gjatë gjashtë mujorit të parë të gjithë e dimë që ka pasur pengesa sepse ka qenë një aktivitet se kompanitë kontraktuese prej nivelit qendrorë të cilat kanë qenë tu punuar për me realizuar projektin rrugës kryesore dhe si alternativë ka qenë rruga e vjetër, e kjo ka qenë si çështje kryesore sepse mjetet kanë kaluar ka ajo pjesë dhe normal që kanë shkaktuar pakënaqësi te qytetarët në komunikacion dhe policia është e obliguar me raportuar në këshillin komunal për siguri në bashkësi.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

6. Raportin financiar për periudhën Janar – Qershor 2025 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:-te kompania Pastrimi asnjë herë nuk është bërë auditim, kërkoj që ti bëhet auditimi kësaj kompanie.

Refet Kalisi thekson:- vërejtje kam te shpenzimet higjienike po më doket një vlerë bukur e madhe 2442.00€. Kërkoj sqarim se për këtë shumë të mjeteve.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

7. Informatë për sektorin e emergjencave.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Arsim Dernjani thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Zaim Bela thekson:- në raport shënon njëzet e një dalje dhe njëzet e një intervenime, mirëpo po më intereson sipërfaqet e djegura me pyje private dhe ato publike ,a ka raportuar sektori i zjarrfikësve për këtë çështje sepse është dashur me bërë raport se sa hektarë janë djegur . Temperaturat kanë qenë shumë të larta dhe një pjesë është djegë edhe te fshati Laç.

Arsim Dernjani thekson:- në kontaktet që i kam pasur me komandantin e zjarrfikësve vetëm këto informacione i ka përcjell dhe për raport më të detajuar ka potencuar se do tu a sjellim më vonë.

Resul Suma thekson:- unë vetëm deshta ta bëjë një falënderim ndaj punëtorëve të zjarrfikësve duke filluar nga komandanti zjarrfikësve dhe për zyrtarët e tjerë. Ditën e djeshme kam pasur një rast në fshatin Dimcë që ka qenë një zjarr por kërkoj nga qytetarët që të jenë më të vëmendshëm sepse afër një muaj e gjysmë nuk ka pasur reshje të shirave e mund të ndodhë që prej një duhani mundet të shkaktohet zjarri. Kërkoj që të jenë më të përgjegjshëm qytetarët sepse ditën e djeshme zjarrfikësit janë mundur shumë deri sa e kanë shuar zjarrin.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hanumshahe Dibrani thekson:- kërkoj sqarim nga drejtorja për shërbime publike për ujin e fshatit Glloboçicë për shkak se afër dy muaj vetëm një orë në dit ka ujë. Është mirë që të dilni me sqaruar se ku është problemi i ujit. Probleme po ka ndonjë herë e dhe uji i fshatit Dimcë.

Arsim Dernjani thekson:-sqarime më të detajuara mund ti merrni te kompania Bifurkacioni për shkak se përgjegjës kryesorë për çështjen e ujit është kjo kompani.

Hanumshahe Dibrani thekson:- qytetarët adresohen te komuna për këtë çështje , ju duhet me sqaruar.

Arsim Dernjani thekson:-adresimi kryesorë është te kompania Bifurkacioni nga ata duhet të kërkohet llogari për shkak se pagesa atyre u bëhet.

Resul Suma thekson:- kërkoj informacion për dy projekte që janë tu realizuar në fshatin Gorancë-Krivenik, rruga a do të vazhdohet me u shtruar me asfalt deri në fshatin Krivenik. Për projektin e shtyllave elektrike që është duke e realizuar KEDSI në fshatin Krivenik. Tregu i gjelëbr ka qenë kërkesë e jona dhe e pashë në postim që ka me u realizuar , në cilin vend do të rregullohet dhe kur do të realizohet.

Sevdi Dernjani thekson:- është e vërtetë që qytetari për çështjen e ujit zgjidhjen e kërkon të komuna por gjatë tri viteve të fundit është punuar shumë në rregullimin e ujit në komunën e Hanit të Elezit, kemi raste konkrete që është përmirësuar dukshëm gjendja e ujit dhe në tri vitet e fundit kemi punuar sa njëzet vitet e më hershme në këtë drejtim sa është punuar te puna e ujit. Ka pasur ujë sa i përket komunës së Hanit të Elezit është shumë fakt dhe realitet që në këto dy muajt e fundit nuk ka pasur por nuk është një problem që na mundemi me zgjidhur për shkak të mungesës së reshjeve që ka pasur dhe për shkak mungesës së burimit ujit të cilat nuk ka pasur ne vendet e burimit të ujit e që është bërë furnizimi për mes atyre vend burimeve është bërë furnizimi tek qytetarët , pra ujë nuk ka pasur për shkak të mungesës së reshjeve dhe mungesës së ujit në burimet në të cilat na e marrim ujin. Te rruga Gorancë-Krivenik është tu u punuar , është në fazën e punimeve faza e parë që është prej fshatit Gorancë deri te vendi i quajtur te Pishat e cila përfshinë një vlerë prej 400 000 € dhe është e gjatë një pikë tetë kilometra . Faza e parë e projektit të parë të shtrimit të asfaltit është përfunduar dhe në një kohë shumë të shkurtë do të përfundon edhe faza e dytë . Sa i përket fazës së dytë të projektit deri në fshatin Krivenik është në përfundim e sipër të procedurave pra është në vlerësim te zyra e prokurimit dhe po besojë që shumë shpejt do të përfundon edhe kjo por saktë nuk mund të themi sepse është projekt tre vjeçar, në këtë vit do të shfrytëzohet e konsiderueshme për fillimin e punimeve të asaj pjese. Par dy jave kam pasur takim me drejtorin gjeneral i cili më ka njoftuar për projektin e shtyllave elektrike në fshatin Krivenik do të përfundon me një kohë shumë të shpejtë , e ka nxitur punëkryesin sepse projekti është mes Qeverisë dhe KEDSIT por kjo është vetëm për me i informuar qytetarët.

Refet Kalisi thekson:- nuk u pajtova me atë që potencuat që njëzet vite nuk është punuar sa kemi punuar për katër vite . Prej vitit 2011 deri në vitin 2021 janë dhënë një milionë e katërqind e gjashtëdhjetë mijë euro për çështjen e ujit dhe unë nuk e di sa keni investuar ju.

Sevdi Dernjani thekson:-një pjesë të vogël të atyre mjeteve i ka dhënë komuna, ndërsa pjesën më të madhe e ka dhënë CDI-ja . Kur potencova që nuk është punuar potencova se fatkeqësisht janë futur gjithë ato mjete dhe ai projekt ka qenë i harruar dhe nuk ka pasur besim që do të përfundon . Kur kemi ardhur në qeverisje ne e dimë shumë mirë punën të cilën e kemi bërë ne dhe e kemi finalizuar si projekt shumë që po e aludoni që është investuar prej komunës po nuk është investuar prej komunës. Nga viti 2021 deri në vitin 2025 është punuar shumë sa i përket rregullimit dhe konkretizimit të këtyre punimeve. Ne kemi mundur me i shtijë edhe dy milion euro por nëse nuk ka pasur konkretizim fatkeqësisht nuk është projekt që mundemi me quajtur të suksesshëm. Vetëm angazhimi i kohës duke i gjetur persona të cilët kanë humbur në atë projekt na ka marr kohë një vit e gjysmë duke i gjet personat e CDI-së dhe Ministrisë për me i bërë bashkë , pastaj tu e nxjerr në kontratë pranim dorëzimin e fabrikës në kompetencat e kompanisë Bifurkacioni e kështu me radhë na e ka marr një periudhë shumë të madhe të kohës . Ne nuk kemi mundur me bërë një alternativë tjetër sa i përket rregullimit të çështjes së ujit pa e përfunduar një projekt në të cilin kanë hyrë mjete financiare në atë fabrikë. E rendit është që me u finalizuar ky projekt e pastaj të kërkohen alternativa tjera ose burime tjera sa i përket ujit në komunën tonë.

Zaim Bela thekson:-e dëgjova mendimin e drejtorit dhe mendimin tënd por duhet me u arsyetuar disi, kena punuar shumë i bjenë që operacioni i suksesshëm por pacienti ka vdekur por ne duhet ta themi realitetin por realiteti është që nuk ka ujë, nuk kemi punuar as përpara as tash se qytetari është tu hekë për ujë këta duhet ta thoni sepse thoni është punuar shumë por na pi shohim rezultatet dhe rezultatet janë që ujë nuk kanë qytetarët. Ne i kuptojmë thatësira por nuk lidhen me atë që ne kemi punuar dhe rezultati në fund nuk ka ujë mirëpo ne duhet me bërë përpjekje me bërë zgjidhje por a mundemi me arritur është çështje tjetër.

Arsim Dernjani thekson:-nuk është e vërtetë që nuk ka ujë por problem ka qenë dy dytë në disa pjesë për shkak të thatësirave por tash kemi bërë edhe një shtesë përmes pompave dhe pjesa e qyteti ujë ka.

Sevdi Dernjani thekson:-është shumë e vërtetë që jemi në kohë të thatësirave edhe mungesa e ujit është eventuale e nuk mundemi me i ikur kësaj përgjegjësie për shkak të mungesës së burimeve të ujit ashtu siç potencova edhe më herët. Sa i përket konkretizimit të punimeve të cilat janë bërë prej kësaj qeverisje janë eventuale sepse i sheh gjithë secili dhe kësaj nuk mundemi me i ikur për shkak se qytetarët për tre vite e kaluara kanë pasur ujë por fatkeqësisht është kohë thatësire e ka mungesë të ujit në burime dhe për këtë arsye ka reduktime të ujit dhe kompania Bifurkacioni duhet të del me njoftime dhe prej anës komunës i kemi dhënë rekomandime kompanisë por është një përgjegjësi që i takon kompanisë Bifurkacioni me të drejta ekskluzive prej nivelit qendrorë. Unë personalisht kam parashtruar kërkesë në nivel qendrorë për me menaxhuar kompaninë e Bifurkacionit në nivel lokal por nuk na lejojnë sepse është e kundërligjshme. E jona është që gjitha kërkesat sa i përket kompanisë Bifurkacioni me i realizuar , ka pas kërkesa për ujëmatës, ka pasur kërkesa për shtyllat elektrike në fabrikën e ujit , ka pasur kërkesa për gjeneratorë , kërkesë ka pasur për rregullim të hapësirës së bazenit dhe të gjitha kërkesat e tjera ja kemi plotësuar dhe gjithmonë kemi me ja plotësuar .

Majlinda Kaloshi thekson:- kërkesë ka qenë ringjallja e tregut ditorë në Han të Elezit dhe sipas projektit sistemi fleksibil i kioskave që do të vendosën këtu do të mund të shfrytëzohen jo vetëm për treg ditorë por edhe për panaire dhe festivale të ndryshme. Pozicioni i tyre është në qendër të qytetit me një hapësirë që po mendojmë me bërë shpronësimin pjesa mbrapa komunës dhe kemi menduar në vitin e ardhshëm.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:45.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta





REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA • OPSTINA • MUNICIPALITY
HANI ELEZIT
Nr. i Prot. 02/6024
Nr. i Faq. 1 Data: 05.08.2025



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit

| | |
|--------|--|
| DATA: | 05.08.2025 |
| PËR: | Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin e Komunës |
| NGA | Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit z. Mehmet Ballazhi |
| LËNDA: | Shkresë Përcjellëse: Prezantimi dhe diskutimi i Raportit të Punës së Kryetarit të Komunës për periudhën janar – qershor 2025 |



Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe për të siguruar transparencën dhe llogaridhënien ndaj qytetarëve, ju përcjellim për shqyrtim Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës për periudhën janar – qershor 2025.

Ky raport përmban një pasqyrë të detajuar të aktiviteteve, projekteve dhe arritjeve të realizuara gjatë vitit, si dhe sfidat me të cilat jemi përballur. Prezantimi i raportit dhe diskutimi i tij në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin e Komunës është një hap i rëndësishëm për vlerësimin e punës së institucioneve komunale dhe për përcaktimin e prioriteteve të mëtejshme.

Ju ftojmë të shqyrtoni raportin dhe të jepni vlerësimet dhe rekomandimet tuaja.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS--REPUBLIC OF KOSOVA
MUNICIPALITY OF ELEZ HAN
KOMUNA HANI I ELEZIT

DREJTORIA PËR URBANIZËM, KADASTER DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Nr.06/_ 2025

| | |
|---------|---|
| DATË: | 05.08.2025 |
| PËR: | KPF dhe Kuvendin Komunal |
| PËRMES: | z. Mehmet Ballazhi – Kryetar i Komunës Hani i Elezit |
| NGA: | Nexhmedin Daci– Drejtor për Urbanizëm, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit. |
| TEMA: | Shkresë përcjellëse- Propozim vendim për miratimin e Planit Zhvillimor të Komunës 2025-2033 |

Të nderuar:

Me anë të kësaj shkresë përcjellëse ju përcjellim Propozim-Vendimin për miratimin e PLANIT ZHVILLIMOR TË KOMUNËS Hani i Elezit 2025-2033. Ky propozim-Vendim është i bazuar në nenin 12 shkronja d dhe neni 17 paragrafi 1 shkronja b e Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28\2002, e në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1.2 pika 1.2.1, neni 6 paragrafi 1.2 pika 1.2.1, neni 10 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 dhe nenet 11 dhe 15 të Ligjit nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, Udhëzimit Administrative (MMPH) nr.11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale, Udhëzimit Administrativ (MMPH) nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor, Vendimit për dhënjën e pëlqimit për miratimin e Planit Zhvillimor të Komunës Hani i Elezit 2025-2033 me nr. 4351-2/25 të dt.31.07.2025 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, si dhe neni 76 pika a të statutit të Komunës Hani i Elezit.

Bashkëlidhur me shkresën keni:

- Propozim-Vendimin për miratimin e PZHK-s
- Draftin final të Planin Zhvillimor të Komunës 2025-2033 (CD),
- Raportin nga shqyrtimi publik i PZHK-s (CD),
- Vendimin për dhënjën e pëlqimit për miratim të PZHK-s nga MMPHI-s (CD).

Me respekt.



REPUBLIKA E KOSOVËS--REPUBLIC OF KOSOVA
MUNICIPALITY OF ELEZ HAN
KOMUNA HANI I ELEZIT



Bazuar në nenin 12 shkronja d dhe neni 17 paragrafi 1 shkronja b e Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28\2002, e në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1.2 pika 1.2.1, neni 6 paragrafi 1.2 pika 1.2.1, neni 10 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 dhe nenet 11 dhe 15 të Ligjit nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, Udhëzimit Administrative (MMPH) nr.11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale, Udhëzimit Administrativ (MMPH) nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor, Vendimit për dhënjen e pëlqimit për miratimin e Planit Zhvillimor të Komunës Hani i Elezit 2025-2033 me nr. 4351-2/25 të dt.31.07.2025 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, si dhe neni 76 pika a të statutit të Komunës Hani i Elezit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. xx.xx.2025, merrë këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR TË KOMUNËS HANI I ELEZIT 2025-2033

Neni 1

Miratohet Plani Zhvillimor Komunal i Komunës Hani i Elezit për periudhën kohore 2025-2033, si dokument themelor i planifikimit hapësinor dhe zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik të Komunës.

Neni 2

Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) është plan strategjik multi sektorial i cili percakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik social dhe hapësinor të komunës Hani i Elezit dhe si i tillë përfshinë planin për zhvillimin e gjitha zonave urbane dhe rurale për një periudhë kohore 8 vjeqare.

Neni 3

Plani Zhvillimor Komunal është hartuar në pajtim me Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020+, dokumentet strategjike sektoriale, dhe rekomandimet e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të Republikës së Kosovës.

Neni 4

Ky Plan do të shërbejë si bazë për hartimin dhe miratimin e dokumenteve tjera të planifikimit hapësinor dhe zhvillimit komunal.

Neni 5

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit të Komunës Hani i Elezit.

Neni 6

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës së Hanit të Elezit.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Plani ekzistues Zhvillimor i Komunës 2010-2025+.

Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit,
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal,
- Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës,
- Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtja e Mjedisit si dhe
- Arkivit të Komunës.

05.08.2025
Hani i Elezit

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
z. Florim Shkreta



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



Nr. 05/ 6020 /2025

| | |
|-------|--|
| DATA | 05.08.2025 |
| PËR | KPF dhe Kuvendin e Komunës |
| NGA | Hisni Luri Drejtor i Arsimit |
| LËNDA | Informatë për suksesin e përfundimit të vitit mësimor të vitin shkollor 2024/2025 |



Të nderuar:

Po ju përcjellim informatën për suksesin e përfundimit të vitit mësimor të vitin shkollor 2024/2025

Me respekt,

DREJTORIA PËR ARSIM

INFORMATË

Për suksesin e përgjithshëm të përfundimit të vitit mësimor për viti shkollor 2024/2025

Gusht 2025 , Hani i Elezit

Kuadri arsimor në vitin shkollor 2024/2025

Në vitin shkollor 2024/2025, kuadri arsimor sipas kualifikimit në nivelin komunal janë gjithsejtë 107-mësimdhënës, 98.13% prej tyre janë të kualifikuar, 2 prej tyre janë me kualifikim jo adekuat, 1.86% të pakualifikuar nuk ka. (shih në tabelën 1)

Tabela: 1

| KUADRIT ARSIMOR NË VITIN SHKOLLOR 2024/2025 | | | | | | | | | | | | | |
|---|-------------------------------|-------------|----|-------|----|-------|----------------|-------|--------------------------------|-------|------------------|------|--|
| Nr. | EMRI I SHKOLLËS | MËSIMDHËNËS | | | | | TË KUALIFIKUAR | | TË KUALIFIKUAR (Jo adekuat) | | TË PAKUALIFIKUAR | | |
| | | GJ. | M | % | F | % | GJ. | % | GJ. | % | GJ. | % | |
| 1 | SHFMU" ILAZ THAÇI" | 65 | 19 | 29.23 | 46 | 70.76 | 65 | 100 | 0 | 0.00 | 0 | 0.00 | |
| 2 | SHFMU" KËSHTJELLA E DITURISË" | 11 | 5 | 45.45 | 6 | 54.54 | 11 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 3 | SHFMU" VELI BALLAZHI" | 12 | 4 | 33.33 | 8 | 66.66 | 12 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 4 | SHML" DARDANIA" | 19 | 10 | 52.63 | 9 | 47.36 | 17 | 84.21 | 2 | 15.78 | 0 | 0.00 | |
| GJITHSEJTË | | 107 | 38 | 35.51 | 69 | 64.48 | 105 | 98.13 | 2 | 1.86 | 0 | 0 | |

Krahasimi i kuadri arsimor mes vitit shkollor 2023/24 & 2024/25

Krahasimi i kuadrit arsimor mes vitit shkollor 2023/24 & 2024/25 është i ndryshëm te kualifikimi është zvogëluar për 1.87% dhe gjinia femrore është rritur për 2.22%, (shih në tabelën 2)

Tabela: 2

| KRAHASIMI I KUADRIT ARSIMOR MES VITIT SHKOLLOR 2023/24 & 2024/25 | | | | | | | | | | | | | |
|--|------|-------------|----|-------|----|-------|----------------|-------|--------------------------------|-------|------------------|------|--|
| Nr. | VITI | MËSIMDHËNËS | | | | | TË KUALIFIKUAR | | TË KUALIFIKUAR (Jo adekuat) | | TË PAKUALIFIKUAR | | |
| | | GJ. | M | % | F | % | GJ. | % | GJ. | % | GJ. | % | |
| 2023/24 | | 106 | 40 | 37.73 | 66 | 62.26 | 106 | 100 | 0 | 0.00 | 0 | 0.00 | |
| 2024/25 | | 107 | 38 | 35.51 | 69 | 64.48 | 105 | 98.13 | 2 | 1.86 | 0 | 0 | |
| KRAHASIMI | | +1 | -2 | -2.22 | +3 | +2.22 | -1 | 1.87 | +2 | +1.86 | 0 | 0 | |

Numri i nxënësve për gjysmëvjetorin e dytë në vitin shkollor 2024/25

Numri i nxënësve Parafillor në nivel komunal gjithsejtë janë 124nx. prej tyre 66 nx.femra

Numri i nxënësve nga klasa e I-V në nivel komunal gjithsejtë janë 660nx. prej tyre 311nx femra.

Numri i nxënësve nga klasa e VI-IX në nivel komunal gjithsejtë janë 515nx. prej tyre 247nx femra

Numri i nxënësve nga klasa e X-XII në nivel komunal gjithsejtë janë 287nx. prej tyre 146nx femra

